

VENDIM
Nr. 40, datë 21.12.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Altin Binaj,	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 21.12.2021, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë plenare publike, çështjen nr. 1 (F) 2021 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fatos Tushe, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Ardian Visha dhe Antoneta Sevdari.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Embro Ahmetaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 407, datë 6.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Lushnjë, z. Fatos Tushe”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 13, 17, 30, 33, 42, 115, 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të *KEDNJ*-së; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes së paraqitur nga kërkuesi Fatos Tushe, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Fatos Tushe është zgjedhur kryetar i Bashkisë Lushnjë në zgjedhjet e zhvilluara në datën 30.6.2019 për njësitë e qeverisjes vendore.

2. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*SPAK*), në kuadër të procedimit penal nr. 199, ka vijuar hetimet në ngarkim të kërkuetit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*).

3. Me vendimin nr. 50, datë 5.7.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka caktuar, mes të tjerash, edhe masën e sigurimit “Arrest në burg” për kërkuetin, e cila është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore në datën 6.7.2021.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Brendshëm, në datën 6.7.2021 ka marrë vendimin nr. 407 (*vendimi nr. 407/2021*) “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Lushnjë, z. Fatos Tushe”, me motivacionin “*për shkak të shkeljeve të rënda*”. Vendimi ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, të datës 7.7.2021.

5. Kërkuesi, i përfaqësuar nga avokatët e zgjedhur prej tij, në datën 5.8.2021, nëpërmjet shërbimit postar, ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 407/2021, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

6. Kolegji i Gjykatës në datën 19.10.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. Kërkuesi, në ankimin drejtuar Gjykatës, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

7.1 Për legjitimitimin ratione temporis

7.1.1 Kërkesa është paraqitur brenda afatit 15-ditor, të parashikuar nga pika 2 e nenit 115 të Kushtetutës, pasi për vendimin e shkarkimit nga detyra ka marrë dijeni në datën 29.7.2021, pas komunikimit me avokatët e zgjedhur në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku po shqyrtohej ankimi ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit.

7.2 Për themelin e kërkesës

Vendimi nr. 407/2021 cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në aspektet e mëposhtme:

7.2.1 E drejta për t’u njoftuar dhe dëgjuar, pasi nuk i janë njoftuar të gjitha aktet administrative dhe nuk i është dhënë mundësia për t’u dëgjuar ose për t’u mbrojtur përpara marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

7.2.2 Standardi i arsytimit të vendimit, pasi nuk është respektuar procedura dhe forma për nxjerrjen e tij. Vendimit i mungon përshkrimi, arsytimi, përcaktimi i mjeteve ligjore dhe afati për kundërshtimin e tij.

7.2.3 Parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi nuk ka asnjë vendim gjykatë të formës së prerë për dënimin penalisht të tij. Referuar edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, shkarkimi nga detyra vetëm për faktin e fillimit të një procedimi penal dhe për shkaqe që lidhen vetëm me veprën penale, nuk përbën shkelje të rëndë të ligjit, në kuptim të pikës 1 të nenit 115 të Kushtetutës.

8. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar duke argumentuar:

8.1 Për legjitimitimin ratione temporis

8.1.1 Vendimi nr. 407/2021 i është dërguar me shkresën nr. 3315/1 prot., datë 7.7.2021, Ministrisë së Brendshme, Bashkisë Lushnjë dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 7.7.2021.

8.2 Për shfuqizimin e vendimit nr. 407/2021

8.2.1 Pretendimi se është mohuar e drejta për t’u njoftuar, dëgjuar ose mbrojtur përpara marrjes së masës administrative, është i pabazuar. Këshilli i Ministrave, pas njoftimit në faqen zyrtare të SPAK-ut, i është drejtuar menjëherë këtij institucioni për marrjen e informacionit përkatës. SPAK-u, me shkresën nr. 5325/1, datë 6.7.2021, ka informuar se në bazë të informacionit të Policisë Gjyqësore ka regjistruar procedimin penal mes të tjerëve edhe ndaj shtetasit Fatos Tushe, si person ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 25 dhe 248 të KP-së Në këto kushte, pas vlerësimit të situatës, bazuar edhe në shkronjën “a” të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), Këshilli i Ministrave, në kushtet e urgjencës, ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra. Ndaj kërkuetit është ekzekutuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, gjë që ka sjellë pamundësi për të respektuar të drejtën për t’u dëgjuar, por, gjithsesi, akti nëpërmjet shkresës nr. 3315/1 prot., datë 7.7.2021, iu është dërguar institucioneve përkatëse.

8.2.2 Vendimi nr. 407/2021 i plotëson detyrimet kushtetuese dhe ligjore në drejtim të vlefshmërisë formale dhe rregullave të teknikës së hartimit të akteve administrative individuale. Projektvendimi është i shoqëruar me relacionin shpjegues të ministrit të Brendshëm, për të cilin

kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për t'u njohur. Relacioni, bazuar në nenin 100 të KPA-së përmban qëllimin, bazën ligjore dhe faktet konkrete, të cilat përbëjnë shkelje të rënda. Ndërsa mjetet e ankimit dhe afati janë përcaktuar drejtpërdrejt në Kushtetutë e, si rrjedhim, pretendimi *për cenimin e standardit të arsyetimit* është i pabazuar.

8.2.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar. Në rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë, ky parim nuk zbatohet si në procesin penal, jo vetëm për shkak të natyrës administrativo-disiplinore të procesit, por edhe për shkak të përbërjes, organizimit dhe funksionit të Këshillit të Ministrave.

8.2.4 Procedura e shkarkimit të kryetarit të bashkisë dhe ushtrimi i kompetencës nga autoritetet politike shtetërore karakterizohet nga një hapësirë vlerësimi diskrecionale, e cila vendos në baraspeshë vlerën e përfaqësimit të organeve të zgjedhura me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre, duke respektuar procesin e rregullt ligjor. Në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, rrethanat dhe faktet për kërkuesin përbëjnë shkelje të rënda dhe shkak për shkarkimin e tij. Gjithashtu, ndaj tij ka nisur edhe një procedurë administrative për shkeljet, për të cilat është konstatuar përgjegjësi administrative dhe jopenale, duke arritur në vendimmarrje për shkarkimin e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata fillimisht vëren se pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, konkretisht në datën 18.12.2021, kërkuesi ka paraqitur kërkesë, me objekt *“Heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit kushtetues të paraqitur pranë jush dhe i të drejtave që pretendonim të realizonim nëpërmjet tij.”*. Kjo kërkesë është depozituar në datën 21.12.2021, para fillimit të seancës plenare publike, nga një person i paautorizuar për këtë qëllim nga kërkuesi.

10. Gjatë seancës plenare të datës 21.12.2021, Gjykata, pasi ka shqyrtuar paraprakisht kërkesën e lartpërmendur, ka konstatuar se ajo ishte nënshkruar vetëm nga kërkuesi, i cili ndodhet në masën e sigurimit personal “Arrest në burg”. Me qëllim konfirmimin e vullnetit të shprehur nga kërkuesi, Gjykata, me shkresën nr. 1(F) 2021 të Regjistrit Themeltar të datës 21.12.2021, i është drejtuar Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale nr. 313, Tiranë (IEVP), pranë të cilit po ekzekutohet masa e sigurimit personal të kërkuesit, duke vendosur shtyrjen e gjykimit të çështjes për në orën 12:30.

11. Me shkresën nr. 2601 prot., datë 21.12.2021 të IEVP-së, kërkuesi ka konfirmuar vullnetin e tij për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes së shprehur në kërkesën e datës 18.12.2021. Ky konfirmim i kërkuesit është nënshkruar prej tij në prani të dy juristëve dhe të specialistes së edukimit të IEVP-së.

12. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, në lidhje me kërkesën për heqjen dorë të kërkuesit, gjatë seancës plenare kërkoi pranimin e saj dhe pushimin e gjykimit, pasi shqyrtimi nuk paraqet interes publik.

13. Në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet: *“1. Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes. 2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.”*. Ndërsa në pikën 2 të nenit 43/b të po këtij ligji parashikohet: *“Kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa.”*.

14. Për sa më lart, Gjykata, bazuar në dispozitat e sipërcituara të ligjit nr. 8577/2000, vlerëson se në rastin konkret shqyrtimi i çështjes nuk paraqet interes publik dhe se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.12.2021.

Shpallur më 19.1.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Përparim Kalo, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Sonila Bejtja